

**SBASHK****Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures**

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT*E-buletin***Shtator, 2022**

Reagim i Sindikatave të Arsimit të Evropës ndaj veprimeve të Qeverisë Kurti
Miliona mësimdhënës nga Evropa në përkrahje të SBASHK-ut



Pasi ka marrë informacione ditore për grevën e përgjithshme në sektorin e arsimit dhe të shërbyesve civil dhe për presionet e deklaratat nxitëse të qeveritarëve, drejtoresha e përgjithshme e Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës (ETUCE), znj. Susan Flocken ka zhvilluar takim nga larg me kryetarin Rrahman Jasharaj dhe udhëheqës të tjerë të ... (faqe 4)

Sindikata e mësuesve të Amerikës (AFT) në mbështetje të SBASHK

Mbështetje e fuqishme nga mësuesit e Amerikës

Sindikata e mësuesve të Amerikës (AFT) ka bashkëpunim të shkëlqyer me SBASHK-un për vite me radhë. Kjo ... (faqe 7)

Interesim i madh i mediave për vizitën e znj. Flocken në Kosovë



“Nuk kemi asnjë lëvizje fatkeqësisht dhe kemi pritur shumë ... (faqe 3)

Koha dhe faktet e dëshmojnë të vërtetën

Humanizëm dhe heroizëm i rrejshëm i zonjës Nagavci



Zonjën Nagavci e kishim njoftuar ... (faqe 5)

SBASHK-u nuk ishte e as nuk është vetëm

Zëri i 11 milionë mësuesve të Evropës arriti në Kosovë



Kanë përcjellë me vëmendje ... (faqe 6)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture

Editorial

Unitet i dëshmuar në ditë të vështira



Janë bërë plot 32 vite që kur nisi të përmendej me respekt emri i sindikatës së arsimit të Kosovës. Kjo sindikatë që mori emërtimin SBASHK kreu me dinjitet e krenari misionin e saj në gjithë vitet e okupimit duke qenë shtyllë e fortë e luftës së dritës kundër errësirës. Edhe në vitet e pasluftës SBASHK vazhdoi rrugëtimin duke ruajtur miqësinë me miqtë ndërkombëtarë që kishin ngritur zërin kudo në botë në mbrojtje të arsimit shqip e duke pasur si shembull të shkëlqyer SBASHK-un që nuk po dorëzohej karshi dhunës, persekutimit e burgosjeve sepse dielli e di rrugën e vetë. SBASHK-u edhe në vitet e pasluftës u angazhua për dialog, por edhe bëri protesta e greva që në kohën kur ende në Kosovë po pyetej UNMIK-u. U bë protestë madhështore atë botë dhe SBASHK-u i tha kësaj administrate se do pagën mujore bile sa është një mëditje e zyrtarëve të UNMIK-ut. Në

atë kohë nuk kishte as PAN, as LVV e as parti të tjera në pushtet e SBASHK-u zhvillonte beteja në emër të kërkesave të anëtarësisë.

Erdhi koha e shumë pritur që të kemi qeveritë tona e për çka mësuesi kishte bërë gjithë angazhimet sublime. Me qeveritë e Kosovës u përballëm dhe u përplasëm, por ishim palë e barabartë. Kjo nuk ndodhi në këtë vitin 2022. Kërkesat legjitime të anëtarësisë u injoruan, u përbuzën dhe SBASHK-u u përball me fyerje e shantazhe me të vetmin qëllim që të thyhej, por kjo nuk ndodhi. Anëtarësia ishte dhe mbeti unike. Në të kaluarën ministrat na kritikonin aty e këtu, por edhe takoheshin e bënë angazhime për të dalë nga situatat e krijuara, kurse kjo ministria tani, që dikur thurte vargje heroike për SBASHK-un, nuk pushoi së kritikuari e së vepruari që të plotësonte kërkesat e idetë anti-sindikatë të shefit. Nuk arriti dhe duhet të njehet keq e të kërkoj falje.

Ajo të mos harroi se SBASHK-u ishte dhe mbetet zë i anëtarësisë sepse dielli e di rrugën e vetë dhe ata qëndrojnë me dinjitet me moton *Bashkë e në SBASHK*.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sygjerrime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)

përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +383(0)38/ 226 940



Intervista

Interesim i madh i mediave për vizitën e znj. Flocken në Kosovë



“Nuk kemi asnjë lëvizje fatkeqësisht dhe kemi pritur shumë nga ky takim prisnim që Qeveria të lëvizte nga pozicioni i saj”, është shprehur Jasharaj.

Ndërkohë, Flocken theksoi se nuk kanë arritur që të gjejnë një zgjidhje për grevat në arsim.

“Unë erdha nga Brukseli veçanërisht për të gjetur një zgjidhje për këtë çështje, duhet të ju them që patëm një shkëmbim të gjatë, por nuk arritëm të gjejmë zgjedhje për këtë”, u shpreh ajo.

Flocken ka thënë se vazhdojnë ta mbështesin SBASHK-un dhe anëtarët e saj, duke shprehur keqardhjen e saj për moszgjidhjen e situatës.

“Ne vazhdojmë ta mbështesim SBASHK-un dhe anëtarët e saj në vendimet e tyre dhe këtë do ta marrë me vete nga Kosova prapa në Bruksel dhe në anëtarësinë tonë. Ishte e rëndësishme që të jem këtu që t’ua japë mbështetjen e mësuesve dhe se nuk kemi qenë në gjendje të gjejmë zgjidhje për këtë çështje”, ka thënë Flocken. [Zhurnal.mk]



Tutje drejtoresha e Unionit të Sindikatave të Arsimit në Evropë tha se në Kosovë rregullorja e qartëson se paga e mësuesit duhet të vazhdohet edhe përgjatë grevës.

“Është një e drejtë, Qeveria duhet të ndjekë legjislacionin në fuqi, natyrisht”.

E pyetur për qasjen e akterëve tjerë ndaj kryetarit të SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, Flocken tha se Qeveria duhet të sigurojë që të drejtat e sindikatave të respektohen, në mënyrë që lidhshipi i tyre të mund të kryej punën pa u penguar.

“Është e papranueshme që dhuna fizike të përdoret kundër krerëve apo sindikalistëve në përgjithësi”.

Për zgjidhje të situatës, Flocken rekomandoi që në bisedime të përfshihet një palë e tretë.

“Zakonisht kur të dyja palët nuk mund të pikë takohen, ajo që arrihet është një procedurë e zbutjes që vihet në vend, kështu që duhet të kesh një palë të tretë, person të tretë, për të negociuar mes të dyja palëve, në mënyrë që të gjendet një zgjidhje”, ka thënë ajo. [Telegrafi.com]



“E përkrahim SBASHK-un në kërkesat e tyre. Edukimi është një profesion i rëndësishëm, të qenit mësues është e rëndësishme dhe meriton gjithë përkrahjen e nevojshme. Ne kemi informuar Komisionin Evropian për situatën në Kosovë. Erdha këtu për të gjetur një zgjidhje pasi mësuesit janë në grevë dhe kërkojnë rritje të pagave, implementim të sigurimit shëndetësor dhe reformën në skemën pensionale. Nuk kemi qenë në gjendje të gjejmë një zgjidhje për këtë çështje” – tha ajo.

Ndërsa Rrahman Jasharaj, i cili e ka shoqëruar në takim drejtoreshën Flocken, tha se takimi ishte i dedikuar për përfaqësuesen Susan Flocken dhe se nga argumentet u vërejt që Qeveria nuk ka ndryshuar qëndrimet e veta.

“Sot zonja Flocken ka pasur një takim me kryeministrin, e kemi shoqëruar edhe ne. Në emër të tërë sistemit arsimor e falënderoj zonjën Flocken për mbështetjen morale. Sot takimi ishte i dedikuar për zonjën Flocken, është folur në gjuhë angleze dhe shumë gjëra nuk i kam kuptuar, por nga biseda u pa se me gjithë argumentet, Qeveria nuk ka ndërruar qëndrimet e veta”- shtoi Jasharaj.

Jasharaj tutje potencoi se si përfaqësues i SBASHK-ut nuk do mbajë asnjë takim me kryeministrin pa prezencë të mediave. Tutje, sipas tij, orët e humbura në grevë bazuar në kontratë nuk zëvendësohen. [Kallxo.com]

Video konferenca: https://www.facebook.com/watch/live/?ref=watch_permalink&v=4837124913057899 [telenews.al]

Gjatë muajit

Reagim i Sindikatave të Arsimit të Evropës ndaj veprimeve të Qeverisë Kurti
Miliona mësimdhënës nga Evropa në përkrahje të SBASHK-ut



Pasi ka marrë informacione ditore për grevën e përgjithshme në sektorin e arsimit dhe të shërbyesve civil dhe për presionet e deklaratat nxitëse të qeveritarëve, drejtoresha e përgjithshme e Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës (ETUCE), znj. Susan Flocken ka zhvilluar takim nga larg me kryetarin Rrahman Jasharaj dhe udhëheqës të tjerë të SBASHK-ut. Drejtoresha Flocken duke dëgjuar se Qeveria, në vend të dialogut, ka zgjedhur gjuhë presioni e shantazhi ndaj kryetarit Jasharaj, i cili tani

është detyruar të ketë lëvizje të kufizuara për t'i ikur ekseseve që mund të inskenohen nga simpatizantë të partisë në pushtet. Zonja Flocken është interesuar edhe për rrjedhën e grevës dhe për presionet që po bëhen ndaj grevistëve në sektorin e arsimit dhe sektorin e shërbyesve civil.

Shpjegimin e ngjarjeve dhe paraqitjet publike të qeveritarëve dhe për gjendjen e vështirë ekonomike të grevistëve në prag të dimrit, ata me pagat ekzistuese nuk kanë mundësi të sigurojnë as lëndë drusore për ngrohje e lëre më artikuj të tjerë jetësor e kanë emocionuar drejtoreshën e përgjithshme Flocken, e cila ka shprehur përkrahje të fuqishme në emër të 11 milionë anëtarëve nga e tërë Evropa dhe ka shtuar se do të komunikoj edhe me Konfederatën e shërbyesve civilë të Evropës për të alarmuar për gjendjen duke u shprehur e sigurt se kjo Konfederatë, që ka miliona anëtarë do të jetë mbështetëse dhe zë i fuqishëm i Federatës së Sindikatës së Pavarur të Administratës së Kosovës. Ajo ka deklaruar se që tani do të alarmoj Komisionin Evropian dhe sektorët gjegjëse në BE dhe

në koordinim me ta do të udhëtoj në Kosovë për të ofruar përkrahjen e fuqishme për SBASHK-un dhe SPAK-un.



“Qëndroni të palëkundur në mbrojtje të anëtarësisë tuaj edhe përkundër të gjitha këtyre presioneve ju përcillni përkrahjen time dhe të të gjithë anëtarësisë së Sindikatave të Arsimit të Evropës anëtarësisë së SBASHK-ut dhe Kryetarit Jasharaj”, ishte mesazhi i drejtores Flocken në fund të këtij takimi.

Koha dhe faktet e dëshmojnë të vërtetën

Humanizëm dhe heroizëm i rrejshëm i zonjës Nagavci



Zonjën Nagavci e kishim njoftuar muaj më parë me kërkesat legjitime të anëtarësisë dhe e kishim lutur sa herë takoheshim që ato t'i prezantonte në takimet e Qeverisë duke e paralajmëruar se nëse ato nuk shqyrtohen do të vij deri të greva sepse kjo ishte kërkesë e anëtarësisë. Zonja Nagavci as para grevës e as gjatë saj as edhe një herë nuk ishte Ministre e arsimit dhe nuk iu dëgjua zëri në emër të punëtorëve të arsimit, po nuk mungoi e nuk hezitoi me deklarata

urdhëruese e madje edhe plot shantazh e kërcënime. Ajo vazhdoi t'i duartrokiste edhe fyerjeve e deklaratave nënçmuese të Dimalit, Yllit, Dibranit, Sadriut e disa të tjerëve që u ka humbur çdo gjë njerëzore.

Ajo nuk u ndie keq as kur Qeveria ua dha pagat shërbyesve civilë, që bashkë me punëtorët e sektorit të arsimit ishin në të njëjtën grevë shpallur nga BSPK-ja, kurse të punësuarve në sektorin që ajo përfaqëson iu ndalën pagat. Në vend të kësaj ajo i duartrokiti Hekuran Muratit dhe ndëshkimit që po u bëhej punëtorëve të sektorit në të cilin ajo ishte ministre. Zonja Nagavci për t'i hyrë në qejf shefit dhe Hekuranit shkoi edhe me tutje duke nxjerr urdhër se, pos dënimit me paga mësuesit, duhet edhe të zëvendësojnë edhe orët e humbura.

Kur opinionin u ngrit në këmbë kundër ndëshkimit që po i bëhej punëtorëve të arsimit duke shkelur çdo ligj dhe madje edhe anën humane, zonja Nagavci gjoja u

ngrit në këmbë dhe për ta mbuluar turpin e Qeverisë iu bashkua prapë Dimalit e të tjerëve dhe u mundua ta marrë rolin e humanistes dhe heroit duke bërë angazhime që punëtorët e arsimit të paguhen, por nuk e la anash urrejtjen ndaj SBASHK-ut dhe akuzoi pa fijen e fakteve se kryesia i paska lënë në baltë mësuesit dhe se ajo dashka t'i shpëtoi. Nagavci dashka t'i shpëtoi. Ironike kjo nga zonja Nagavci, e cila tërë kohën e grevës dha urdhra dhe nuk la fjalë të keqe pa thënë për grevistët sa për t'ia bërë qejfin Hekuranit dhe shefit të madh. Zonja Nagavci sa për ty e po të pyeteshe ti pagat e shtatorit kurrë nuk do t'i merrnin punëtorët e arsimit që nga çerdhet e deri në universitet, por këtë humanitetin në thonjëza dhe heroizmin tënd në thonjëza u mundove ta shesësh kot te punëtorët e arsimit dhe e bërë me shpresën se do të krijosh përçarje, përçarje që u mundove ta bësh edhe gjatë gjithë grevës, por të shkoi kot. Ruaje atë foton me fëmijën dhe me shefat në bankat shkollore. Vazhdo me

Dimalin, Yllin, Rronin, Sadriun, Dibranin e ndonjë tjetër, që nuk u ka mbetur as edhe një fije nga njerëzorja. Kënaqu e duartrokit kur fyhet e shahet mësuesi, por mos u shtir si heroinë se kot e ke. Punëtorët e arsimit janë bashkë e në SBASHK dhe uniteti i tyre është i pathyeshëm. E ti pyet vetën a ishe bile një ditë ministre e tyre apo i le gjatë ditëve, javëve e muajve në baltë se zë e mbrojtëse e tyre nuk ishe që kur u bërë ministre e që tani. Zonja Nagavci inati dhe mllef i paarsyeshëm ndaj meje e sindikalistëve ua ka bllokuar trurin edhe disa deputetëve të partisë suaj. Njëra prej tyre dje në parlament përsëriti shpifjet e Hekuranit për SBASHK-un dhe që të dy do të jenë në përballje para drejtësisë sepse e kanë tepruar. Boll mo!

Ti vazhdo me Dimalin, Yllin, Rronin, Sadriun, Dibranin e ndonjë tjetër të pini kafe e të lavdëroheni për fyerjet që ia kanë bërë e do ia bëjnë figurës së mësuesit.

SBASHK-u nuk ishte e as nuk është vetëm

Zëri i 11 milionë mësuesve të Evropës arriti në Kosovë

Kanë përcjellë me vëmendje gjithë ngjarjet në Kosovë dhe duke ndjerë shqetësimin e thellë me përballjet që po bënte SBASHK në përpjekjet që të ketë dialog me qeverinë e të arrihej marrëveshje e pranueshme, drejtoresha e përgjithshme e Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës (ETUCE), znj. Suzan Flocken, kishte ndërprerë gjithë angazhimet dhe vizitat e punës dhe i është drejtuar nga Brukseli me kërkesë të prerë Kurtit që të caktonte një takim zyrtar me të në ambientet e Qeverisë. Përgjigja nga Qeveria ishte vonuar ca, por kishte ndodhur. Drejtoresha Flocken erdhi në Kosovë dhe fillimisht u takua me kryetarin dhe stafin e SBASHK-ut duke sjellë zërin e 11 milionë mësuesve të Evropës në përkrahje të kolegëve të tyre në Kosovë.

Kryetari Jasharaj dhe stafi kanë falënderuar zonjën Flocken dhe gjithë anëtarësinë e ETUCE për përkrahjen e vazhdueshme nëpër vite dhe e kanë falënderuar atë që po qëndron në Kosovë për të ndarë nga afër shqetësimet e mijëra anëtarëve të SBASHK-ut që po gjendeshin në grevën e filluar më 25 gusht pa dëshirën e tyre, po për shkak se qeveria duke vazhduar

me qasjen e gabuar ndaj sindikatave dhe dialogut social.



Zonja Flocken në takimin me Kurtin ishte zë i vërtetë i SBASHK-ut duke ua thënë troç Kurtit, Nagavcit dhe Muratit se SBASHK-u ka mbështetjen e fuqishme të 11 milionë kolegëve të tyre nga e tërë Evropa. Ajo ka kritikuar Kurtin për qëndrimin e tij dhe të qeverisë ndaj sindikatave dhe ka insistuar që ai të realizojë

kërkesat legjitime të anëtarësisë duke ia ripërsëritur Kurtit dhe anëtarëve të qeverisë së tij. Kurti ka vazhduar edhe në këtë takim me ligjëratat, të cilat zonja Flocken i ka kritikuar duke u shprehur se po ndahej thellësisht e zhgënjyer nga ky takim dhe se për gjithë këto do të njoftonte komisionet gjegjëse në BE.

Sindikata e mësuesve të Amerikës (AFT) në mbështetje të SBASHK **Mbështetje e fuqishme nga mësuesit e Amerikës**



krenari e vlerësojmë shërbimin tuaj të përkushtuar ndaj anëtarësisë suaj. Në këto kohë të jashtëzakonshme, ndërsa qeveritë në të dyja vendet tona vazhdojnë të shtyjnë ngarkesa më të mëdha të punës arsimore, por ofrojnë më pak burime, ne refuzojmë të lejojmë që mësuesit të fajësohen për një krizë ekonomike që ata nuk krijuan. Mësuesit - dhe motrat e vëllezërit e tyre të sektorit publik janë shpirti i komuniteteve të tyre, dhe ata meritojnë të drejtën për paga të drejta, vlerësim më të madh dhe mirënjohjen tonë. Ne e dimë se në ditët në vazhdim, anëtarët e SBASHK-ut do të mbrojnë të drejtat e tyre, dhe ne qëndrojmë me ju në solidaritet të plotë”, është shprehur në letrën mbështetëse në emër të gjithë anëtarësisë së kësaj sindikate kryetarja e AFT-së, Randi Weingarten.

Sindikata e mësuesve të Amerikës (AFT) ka bashkëpunim të shkëlqyer me SBASHK-un për vite me radhë. Kjo sindikatë numëron 1.7 milionë anëtarë dhe duke përcjellë situatën aktuale dhe përpjekjet e angazhimet e vazhdueshme të SBASHK-ut për realizimin e kërkesave legjitime të anëtarësisë ka shprehur mbështetje dhe solidaritet për gjithë këto përpjekje të SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë.

“Në emër të 1.7 milionë anëtarëve të AFT-së, ne mbështesim mësuesit e Kosovës dhe përpjekjet e sindikatës suaj për paga, respekt dhe njohje. Jemi të nderuar që bashkëpunojmë me SBASHK-un dhe me



Solidaritet me SBASHK-un nga Kongresi i AOB i Holandës

Përschëndetje dhe përkrahje e fuqishme



Ishin ftuar me kohë si mysafirë të nderuar përfaqësuesit e SBASHK-ut në Kongresin e sindikatës mike të punëtorëve arsimor të Holandës. Për arsye se po zhvillonin një betejë të vështirë për realizimin e kërkesave të anëtarësisë dhe greva po vazhdonte me fajin e qeverisë, delegacioni i SBASHK-ut po mungonte në këtë ngjarje të arsimit të Holandës, por

nuk mungoi përkrahja e solidariteti i delegatëve të Kongresit dhe i mysafirëve nga 25 sindikata simotra. Ata duke shprehur solidaritetin u mbledhën bashkë dhe dërguan këtë mesazh domethënës.

“Të nderuar kolegë të SBASHK-ut, Përfaqësues të 25 sindikatave nga 18 vende të mbledhura në Holandë për kongresin e AOb, po ju dërgojnë përschëndetje dhe një mesazh solidariteti. Ne e kuptojmë luftën tuaj, e drejta për dialog social e cila është e sanksionuar në konventat e ILO-s duhet të respektohet. Shpresojmë që ju të mund ta përfundoni grevën tuaj me kokën lart dhe me rezultate të mira në fund, edhe nëse është e vështirë tani. Në foto ne ngremë duart për t’ju mbështetur. Solidaritet”, thuhej në mesazhin e kolegëve tanë që përfaqësojnë mijëra e mijëra anëtarë sindikalistë nga vende të shumta demokratike nga Evropa dhe bota.